

Njësia për Bashkëpunim në Çështjet Policore dhe Institucionet e Privimit të Lirisë

Njësia për Bashkëpunim në Çështjet Policore dhe Institucionet e Privimit të Lirisë (CPDL) (ish Njësia e Bashkëpunimit në të Drejtën Penale) ndihmon shtetet anëtare të integrojnë standardet e Këshillit të Evropës në legjislacionin dhe praktikën kombëtare dhe të adresojnë rekomandimet që vijnë nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës, veçanërisht ato të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës, por edhe të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe Asamblesë Parlamentare.



CPDL zbaton projekte të shumta në fushën e policisë, shërbimit të provës, burgjeve dhe institucioneve të tjera të mbyllura ku qëndrojnë persona të privuar nga liria. CPDL punon drejtpërdrejt me autoritetet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare për të identifikuar nevojat më të spikatura dhe për t'i adresuar ato, si dhe për të sjellë një ndryshim tek përfituesit nëpërmjet asistencës së duhur teknike.

Zhvillon instrumenta që avancojnë reformat në sistemin penitenciar, shërbimin e provës dhe atë policor



Asiston proceset legjislative (nëpërmjet këshillimit, diskutimit, hartimit të akteve)



METODOLOGJIA



Ngre kapacitetet e personelit të shërbimit penitenciar, policisë dhe shërbimit të provës



Kryen aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit

TRE FUSHA KRYESORE VEPRIMI



ZBATIMI I LIGJIT



DËNIMI



LIRIMI ME KUSHT

Konferencë vjetore për çështjet e policisë për të analizuar sfidat e reja si edhe për të shkëmbyer informacione dhe praktika të mira dhe për të forcuar partneritetet



ZBATIMI I LIGJIT



Së shpejti do të prezantohet rrjeti i ri policor



Projektet dhe aktivitetet e bashkëpunimit shumëpalësh dhe dypalësh me autoritetet kombëtare

SISTEMI PENITENCIAR

CPDL mbështet shtetet në forcimin e të drejtave të njeriut për të dënuarit, ofrimin e kujdesit shëndetësor duke përfshirë shëndetin mendor në burgje, zhvillimin e programeve të trajtimit për personat në paraburgim, rehabilitimin e qëndrueshëm të të dënuarve ekstremistë të dhunshëm, bashkëpunimin me sistemin penitenciar dhe shërbimin e provës, rritjen e kapaciteteve të sistemit penitenciar në adresimin e radikalizimit në burgje, përfshirjen e sigurisë dinamike, përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të mitur dhe rritjen e edukimit/trajnitimit të personelit të burgjeve.



SHËRBIMI I PROVËS



CPDL ndihmon shtetet anëtare që të vendosin në praktikë konceptin e shërbimit të provës duke zhvilluar kuadrin e nevojshëm ligjor, institucional dhe operacional.



@CPDL_CoE



www.coe.int/cpdl

